

NJË VËSHTRIM MBI TREGUESIT E ZHVILLIMIT EKONOMIK TË SHQIPËRISË

Janar – Qershor 2019


SEKRETARIATI I KËSHILLIT TË INVESTIMEVE

Korrik 2019

Shënim: Materiali është një përmbledhje e treguesve kryesorë makroekonomikë na Shqipëri dhe rajon të disponueshme deri në datën e publikimit të këtij materiali dhe nuk përfaqëson opinionet apo pikëpamjet e Sekretariatit dhe Këshillit të Investimeve.

Të dhënat e përdorura në prezantim janë gjeneruar nga databazat e faqeve zyrtare të Institutit Shqiptar të Statistikave, Bankës së Shqipërisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtar, etj.

Ecuria e Rritjes Ekonomike




Burimi: INSTAT (Viti 2017 gjysëm final dhe Viti 2018 Vlerësim) dhe MoFE (2019 parashikim)

Rimëkëmbja ekonomike u konfirmua në vitin 2015, dhe ka vijuar në vitet në vijim. Vlerësimet e INSTAT për rritjen gjatë vitit 2018, japin shifrën e 4.06%.

Sipas Kuadrit Makroekonomik e Fiskal 2020-2022 të qeverisë shqiptare rritja ekonomike për vitin 2019 parashikohet në nivelin 4.3%.

Fondi Monetar Ndërkombëtar, në publikimin e tij World Economic Outlook parashikon rritje ekonomike 3,7% gjatë vitit 2019.

E ardhura për Frymë në Vite




Burimi: INSTAT, MoFE Kuadri makroekonomik e Fiskal 2019-2021, Janar 2019; Të dhënat për vitin 2018 janë vlerësime dhe të dhenat për vitin 2019 janë parashikime.

Për vitin 2018, e ardhura për frymë e Shqipërisë vlerësohet 5,309.3 USD në vlerë korrente ose 12,752 USD-PPP bazuar në paritetin e fuqisë blerëse, me një rritje 6% krahasuar me një vit më parë.

Kontributi në rritje sipas sektorëve TI 2019

Kontributi në Rritjen Ekonomike




Burimi : INSTAT

Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) në tremujorin e parë të vitit 2019 u rrit me 2.21% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Kontributin kryesor në këtë rritje e dhanë degët Tregti, Transport, Akomodim dhe Shërbim ushqimor (+0.68 p.p), Aktiviteti i pasurive të paluajtshme (0.51 p.p), Ndërtimi (0.43 p.p). Industria, Energjia Elektrike, Uji dhe Arte, shërbimet argëtuese dhe rekreative, kontribuan negativisht në rritjen e PBB me respektivisht 0.81 p.p dhe 0.54 p.p.

Qarkullimi i mallrave në Tregtinë e Jashtme



Për periudhën Janar-Qershor 2019 eksportet e mallrave arritën vlerën 152 mld lekë, duke u ulur me 3,7 %, krahasuar me një vit më parë, ndërsa importet e mallrave arritën vlerën 318 mld lekë, duke u rritur me 2,6%, krahasuar me një vit më parë.


Deficiti tregtar arriti vlerën 165 mld lekë, duke u rritur me 9,2 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2018.

Në Qershor 2019 eksportet e mallrave arritën vlerën 25 mld lekë, duke u ulur me 4,4%, krahasuar me një vit më parë
Importet e mallrave arritën vlerën 53 mld lekë, duke u ulur me 1,5 %, në krahasim me një vit më parë.

Deficiti tregtar i këtij muaji është 28 mld lekë, duke u rritur me 1,4 %, krahasuar me Qershor 2018.

Eksportet 6M-I në vite

(Sipas grup mallrave, në % ndaj totalit)



Burimi: INSTAT


Në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2019 eksportet e mallrave arritën vlerën 152 mld lekë, duke u ulur me 3.7%, krahasuar me një vit më parë.

Grupet që kanë ndikuar negativisht në uljen vjetore të eksporteve, janë: "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" me -4,5 pikë përqindje, "Materiale ndërtimi dhe metale" me -1,8 pikë përqindje, "Tekstile dhe këpucë" me -0,7 pike përqindje.

Në ndryshimin vjetor të eksporteve ka ndikuar pozitivisht grupi: "Makineri, pajisje, pjesë këmbimi" me +1,2 pikë përqindje.

Importet 6M-I në vite

(Sipas grup mallrave, në % ndaj totalit)



Burimi: INSTAT


Gjatë 6muajorit të parë 2019, importet janë rritur me 2,6 %, krahasuar me 6muajorin e parë 2018.

Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" me +2,7 pikë përqindje, "Materiale ndërtimi dhe metale" me +0,9 pikë përqindje, "Ushqime, pije, duhan" me +0,2 pikë përqindje.

Në ndryshimin vjetor të importeve grupi që ka ndikuar negativisht është grupi: "Makineri, pajisje, pjesë këmbimi" me -0,7 pikë përqindje.

EKSPORTET NË SHËRBIME 2018


KONTEKSTI RAJONAL



Burimi: World Development Indicators

Shqipëria renditet e dyta në rajon në lidhje me eksportet e shërbimeve, të cilat kryesisht dominohen nga eksporti në udhëtime që përbëjnë 60% të totalit.

Indeksi i Çmimit të Konsumit




Burimi: INSTAT

Në grafik paraqitet ecuria e inflacionit mujor me bazë vjetore. Inflacioni duke filluar nga fundi i vitit 2011 ka qënë në mënyrë të vazhdueshme poshtë objektivit të BSH, 3% në një periudhë afatmesme.

Në muajin qershor 2019, ndryshimi vjetor i ICK ishte 1,3%, kur një vit më parë ky ndryshim ishte 2,4 %. Inflacioni mujor në muajin Qershor rregjistroi vlerën -0,3 %.


Forca e Punës 2018

Shkalla e pjesmarrjes në forcën e punës (%)



Burimi: INSTAT

Shkalla e papunësisë





Gjatë vitit 2018, punësimi vijoi ritmet rritëse. Të punësuar vlerësohen të jenë 1230 mijë persona, nga të cilët 43,7% femra. Numri i të papunëve vlerësohet të jetë 173 mijë persona, ndër të cilët 42,3 % janë femra.

Në vitin 2018, sektori i shërbimeve dhe sektori bujqësor shënuan përqindjen më të lartë të të punësuarve me përkatësisht 42,9 % dhe 37,4 % të të punësuarve gjithsej.

Shkalla e papunësisë ka vijuar ritmin rënës të katër viteve të fundit, duke shënuar një ulje 1.4% gjatë 2018 krahasuar me një vit më parë.

Në 2018, qarqet me shkallë punësimi më të lartë për popullsinë 15-64 vjeç janë: Elbasani (61.5%) dhe Korça (59.5%), ndërsa qarku me shkallë punësimi më të ulët është qarku Lezhë (45,6 %). Papunësia më e lartë u regjistrua në qarkun e Vlorës (21.9%) dhe të Lezhës (19.2%).

Forca e Punës Tremujori I 2019




Burimi: INSTAT

Në tremujorin e parë të vitit 2019, shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç është 60,3 %. Gjatë këtij tremujori, në krahasim me të njëjtin tremujor të vitit 2018, numri i të punësuarve gjithsej u rrit me 1,4 %. Krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2018, ky tregues u rrit me 0,6 %.

Në tremujorin e parë 2019, shkalla zyrtare e papunësisë në Shqipëri, për popullsinë 15 vjeç e lart, është 12,1 %. Krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2018, shkalla zyrtare e papunësisë u ul me 0,4 pike përqindje. Krahasuar me tremujorin e katërt 2018, shkalla zyrtare e papunësisë u ul me 0,2 pikë përqindje.

Paga Mesatare sipas Sektorëve (në Lekë)




Burimi: INSTAT

Pagat më të larta në vitin 2018 u regjistruan në sektorin e "Aktiviteteve financiare dhe komunikimit", pasuar nga "Informacioni dhe Komunikimi". Pagat më të ulta janë raportuar në sektorin "Tregti me shumicë dhe pakicë".

Pagat në rritje më të shpejtë janë raportuar në sektorin e artit dhe argëtimit të ndjekur nga aktivitete profesionale dhe administrata publike.


Paga mesatare në vitin 2018 është raportuar në 50,589 lekë (416 EURO) dhe është rritur me 3.3% në terma vjetorë.

Paga Mesatare sipas Sektorëve Tremujori I 2019



■ Paga minimale e miratuar ne lek

■ Paga mesatare mujore për një të punësuar me pagë ne lek



■ Paga mesatare mujore për një të punësuar me pagë ne sektorin privat ne lek


Burimi: INSTAT

Paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë, gjatë tremujorit të parë 2019, është 51.531 lekë, duke u rritur me 4,9 %, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar.

Gjatë tremujorit të parë 2019, paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë në sektorin e aktiviteteve financiare dhe të sigurimit është 97,4 % më e lartë sesa mesatarja në nivel kombëtar, ndërsa në grupsektorin e Bujqësisë, Pyjeve dhe Peshkimit është 26,3 % më e ulët.

Gjatë tremujorit të parë 2019, paga mesatare bruto për grup-aktivitetin Arte, argëtim dhe çlodhje; Aktivitete të tjera shërbimi, ka rritjen më të madhe prej 16,3 %, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar, ndërsa ndërtimi është i vetmi grup-aktivitet që ka ulje prej 2,8 %.

Kosto e Punës për Vendet e Ballkanit Perëndimor, 2018 (EUR)




Burimi: Zyrat Statistikore të vendeve

Kosova ka pagën minimale më të ulët në rajon e ndjekur nga Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut; Paga më e lartë minimale në rajon është regjistruar në Bosnjë&Hercegovinë.

Paga mesatare bruto më e lartë në rajon është në Malin e Zi dhe më e ulta është regjistruar në Shqipëri.

Investimet Publike, Private dhe të Huaja në Shqipëri (në % PBB)




Burimi: Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë, INSTAT


Pjesa më e madhe e investimeve në ekonomi vjen nga sektori i brendshëm i cili mesatarisht jep kontribut në 21% të Produktit të Brendshëm Bruto.

Investimet publike mesatarisht janë rreth 6% e PBB.

Investimet sipas Sektorëve



Burimi: INSTAT – Anketa Strukturore e Ndërmarrjeve




Gjatë vitit 2017, investimet u rritën me 4,7% dhe prodhuesit e shërbimeve zunë 30,9% të investimeve nga 28,3 % që zinin vitin e kaluar.

Sektori me vlerën më të lartë të investimeve të realizuara është sektori i energjisë elektrike, gazit, ujit dhe trajtimit të mbetjeve (31%) kurse peshën më të vogël të investimeve e zënë sektorët e akomodim dhe restoranteve (2,6 %) dhe transporti, infrastrukturë dhe komunikacioni (5,7 %).


Pjesa më e madhe e investimeve, gjatë vitit 2017 ka shkuar për Instalime teknike, makineri dhe pajisje.

Prurjet dhe Stoku i Investimeve të Huaja Direkte

Fluksi në mln EURO



Stoku në mln EURO




Megjithëse fluksi i IHD-ve ka qenë i paqëndrueshëm dhe sipas cikleve të biznesit, stoku i IHD-ve manifeston dinamikë pozitive.

Gjatë vitit 2018 fluksi i IHD-ve u rrit me 13.7% krahasuar me një vit më parë. Ndërkohë gjatë tremujorit I të vitit 2019, stoku i Investimeve të huaja direkte arriti në 7771 mln Euro, dhe fluksi i IHD u rrit me 8% krahasuar me tremujorin paraardhës

Stoku i IHD-ve sipas Vendeve të Origjinës

(Mil EUR)




Burimi: Banka e Shqipërisë

Zvicra udhëheq stokun e IHD-ve në terma vëllimi, 17.7%, e ndjekur nga Greqia me 14.7%.

Dinamika të forta pozitive të IHD-ve nga Holanda (77 mln), Austria (25mln) dhe Franca (12 mln) vërehen gjatë tremujorit I 2019.

Stoku për Tremujor i IHD sipas Aktivitetit Ekonomik (Mil EUR)




Burimi: Banka e Shqipërisë

Sektorët më tërheqës për IHD-të janë Energjia elektrike, Minierat dhe Industritë Nxjerrëse, Sigurimet dhe Pasuritë e Paluajtshme.

Një ngadalësim në stokun e TIK dhe Sektorit të Transportit / Akomodimit vërehet duke filluar nga çereku i dytë i vitit 2017.

Fluksi i IHD në Ballkanin Perëndimor



Burimi: Banka Botërore

Shqipëria renditet e dyta në rajon për vlerën e investimeve të huaja në vite dhe si % ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto.

Stoku dhe Profili i Ndërmarrjeve

Sipas numrit të punësuarve	Viti						
	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Gjithsej	106,837	111,083	112,537	152,288	160,679	162,452	162,835
1-4	95,520	99,782	101,025	136,470	145,456	146,304	145,549
5-9	5,636	5,235	5,387	8,172	7,631	8,023	8,518
10-49	4,439	4,660	4,647	5,994	5,902	6,297	6,801
50+	1,242	1,406	1,478	1,652	1,690	1,828	1,967
Prodhuesit e të mirave	16,413	16,842	16,989	37,950	48,585	53,250	56,916
1-4	12,592	13,071	13,273	33,255	44,179	48,819	52,269
5-9	1,718	1,565	1,603	2,080	1,865	1,842	1,858
10-49	1,650	1,681	1,562	1,971	1,877	1,851	1,987
50+	453	525	551	644	664	738	802
Prodhuesit e shërbimeve	90,424	94,241	95,548	114,338	112,094	109,202	105,919
1-4	82,928	86,711	87,752	103,215	101,277	97,485	93,280
5-9	3,918	3,670	3,784	6,092	5,766	6,181	6,660
10-49	2,789	2,979	3,085	4,023	4,025	4,446	4,814
50+	789	881	927	1,008	1,026	1,090	1,165


Burimi: Anketa e Ndërmarrjeve, INSTAT

Struktura e ndërmarrjeve në ekonominë shqiptare dominohet nga ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme të cilat përfaqësojnë 99% të ndërmarrjeve.

Në vitin 2018, 35% e ndërmarrjeve të regjistruara vepronin si prodhues të mallrave, 65% janë raportuar si operatorë në sektorin e shërbimeve.


Ndërmarrjet Aktive sipas Aktivitetit Ekonomik

Ndërmarrjet aktive fund 2018, % ndaj totalit




Burimi: INSTAT

Ndërmarrjet e reja 2018, % ndaj totalit




Pesha e të ardhurave buxhetore ndaj PBB-së në Vendet e Ballkanit



Burimi: IMF, World Economic Outlook

Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut kanë peshën më të ulët të të ardhurave nga sektori publik në ekonomi, respektivisht 26%, 27.2% dhe 28.5% gjatë vitit 2018.

Dinamikat e Borxhit Publik në % PBB



Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Kuadri Makroekonomik Fiskal, 2020 – 2022

Borxhi publik mbetet i lartë, me një tendencë shumë të lehtë tkurrje pas vitit 2017. Masat e konsolidimit fiskal po kthejnë dinamikën e borxhit publik drejt një borxhi në rënie ndaj PBB-së. Më shumë masa të konsolidimit fiskal do të sigurojnë një tendencë të qëndrueshme kthimi të borxhit publik.


Taksat Kryesore

- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar - 20%
- Tatimi mbi Fitimin, Xhiro Vjetore:
 - 0-5 milion ALL ($\approx$ 36,500 EUR) – 0%
 - Mbi 5 milion – 8 milion ALL ($\approx$ 58,400 EUR) – 5%
 - Mbi 8 milion ALL – 15%
- Tatimi mbi Dividentin – 8%

Renditja e Shqipërisë në Raportet dhe Indekset Ndërkombëtare

Indeksi/ Raporti	Organizata	2015/2016	2016/2017	2017/2018	2018/2019
Perceptimi i Korrupsionit	Transparency International	88 (nga 168 vende)	83 (nga 176 vende)	91 (nga 180 vende)	99 (nga 180 vende)
Liria Ekonomike	The Heritage Foundation	59 (nga 178 vende)	65 (nga 180 vende)	65 (nga 180 vende)	52 (nga 186 vende)
Doing Business	Banka Botërore	97 (nga 189 vende)	58 (nga 190 vende)	65 (nga 190 vende)	63 (nga 190 vende)
Indeksi i Konkurrueshmërisë Botërore	Forumi Ekonomik Botëror	93 (nga 140 vende)	80 (nga 138 vende)	75 (nga 137 vende)	76 (nga 140 vende)

Renditja e Vendeve të Ballkanit Perëndimor në Treguesin e Lehtësisë së të Bërit Biznes



Burimi: <http://www.doingbusiness.org/data/exploreeconomies/>

Renditja e Shqipërisë është përmirësuar me 2 pozicione në raportin 2018/2019.

Indikatorët e *Doing Business*

Indikatori	2014/ 2015	2015 / 2016	2016/ 2017	2018/ 2019
Të fillosh një Biznes	54	58	46	50
Të marrësh një Leje Ndërtimi	122	189	106	151
Të marrësh Energji Elektrike	159	162	156	140
Regjistrimi i Pronës	104	107	106	98
Të marrësh Kredi	36	42	44	44
Mbrotja e Investitorëve Minoritare	18	8	19	26
Të Paguash Taksat	130	142	97	122
Tregtia ndërmjet Kufijve	37	37	24	24
Zbatimi i Kontratave	96	96	116	98
Zgjidhja e Aftësisë Mospaguese	40	42	43	39

Shqipëria renditet më poshtë në fushën e trajtimit të lejeve të ndërtimit, energjisë, procedurave fiskale dhe regjistrimit të pronës.

Ka përmirësime në energji, zbatimin e kontratave dhe regjistrimin e pronave.

Shqipëria renditet më mirë në treguesit e sistemit financiar.

Tregtia përtej Kufijve – Doing Business 2018/2019

Koha dhe Kosto e eksportit

	Shqipëria	Evropa & Azia Qëndrore
Koha - kontrolli në kufi (orë)	9	22.1
Kosto - kontrolli në kufi (USD)	55	157.5
Koha - përgatitja dhe kontrolli i dokumentave (orë)	6	24.3
Kosto - përgatitja dhe kontrolli i dokumentave (USD)	10	97.9
Renditja	Vendi 24 nga 190 ekonomi	

Indikatorët e Konkurrueshmërisë

Indikatori	2015-2016	2016/2017	2017/2018
Institucionet	103	76	68
Infrastruktura	90	91	94
Mjedisi Makroekonomik	122	93	75
Arsimim dhe Shëndet Parësor	62	33	36
Arsimi i Lartë dhe Trajnimet	60	42	80
Efienca e Tregut të të mirave	93	69	49
Efienca e Tregut të Punës	93	98	57
Zhvillimi i Tregjeve Financiare	114	94	91
Gadishmëria Teknologjike	91	82	81
Madhësia e Tregut	105	109	78
Sofistikimi i Biznesit	104	94	105
Inovacioni	120	109	74

Burimi: *World Economic Forum – Competitiveness Report 2018*, <https://www.weforum.org/reports/the-global-competitiveness-report-2018>

Institucionet, efikasiteti i tregut dhe risitë janë përmirësuar.
Edukimi dhe sofistikimet e biznesit janë indksi i konkurrencës në përkeqësim të ndjeshëm.

Treguesit e Lirisë Ekonomike

Shqipëria renditet e 52 në rang botëror, duke u përmirësuar me 2 pikë nga viti i kalur.

Në rang rajonal, Shqipëria renditet e 27a nga 44 vende evropiane.





Vendi qëndron poshtë mesatares evropiane (68.8) por është mbi mesataren botërore (60.8).



Burimi: <https://www.heritage.org/index/about>

Treguesit e Lirisë Ekonomike

Heritage Foundation-heritage.org/Index



2018 EBRD Knowledge Economy Index

	Renditja (46 ekonomi)	Vlerësimi i përgjithshëm	Institucione për inovacion	Aftësi për inovacion	Sisteme innovative	Infrastruktura TIK
Serbia	13	5.13	5.76	5.46	3.26	6.02
Mal i Zi	14	5.04	6.20	5.16	2.88	5.92
Maqedonia e Veriut	22	4.50	5.74	3.83	3.27	5.18
Shqipëria	25	4.36	5.64	4.79	2.36	4.67
Bosnia dhe Hercegovina	29	4.10	5.04	4.13	2.88	4.35
Kosova	35	3.22	4.81	2.75	3.12	2.20

Burimi: <https://www.ebrd.com/news/publications/brochures/ebrd-knowledge-economy-index.html>